



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/55

Datë: 21.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 parografi 4, nenit 93 parografi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 5 paragrafit 2.4, nenit 6 paragrafit 1, nenit 10 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrite e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, në zbatim të rekondimeve të IKShPK-së me qëllim të kontrollit, parandalimit dhe luftimit të përhapjes së virusit SARS-CoV-2, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022 merr këtë:

V E N D I M

Për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19

A. [Zbatimi territorial]

1. Ky vendim zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

B. [Hyrjet dhe daljet e qytetarëve në dhe nga Republika e Kosovës]

2. Çdo person i cili hyn në Republikën e Kosovës duhet të posedojë një nga dëshmitë e mëposhtme:
 - 2.1 Certifikatën e vaksinimit me tri (3) doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen dhe dozë përforcuese) kundër COVID-19;
 - 2.2 Certifikatën e vaksinimit me dy doza (ose me një dozë të vaksinës Janssen) kundër COVID-19, bashkë me testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore).
3. Nga kërkesa për të poseduar ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 2.1 deri 2.2 lironë:
 - 3.1 Personat të cilët hyjnë në Kosovë përmes aeroportit apo përmes pikave kufitare tokësore dhe largohen nga Kosova (transit) brenda tre (3) orësh përmes aeroportit ose pikave kufitare tokësore, me kusht që në hyrje të nënshkruaj deklaratën se do ta lëshojë Kosovën brenda tre (3) orësh dhe që dalja në pikë kufitare të jetë e ndryshme nga hyrja kufitare;
 - 3.2 Personat, të cilët punojnë si transportues profesionist (vozitës), me kusht që të respektojnë protokollin për transport ndërkombëtarë për mbrojtje nga COVID-19;

- 3.3 Shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë dalë jashtë Kosovës në 12 orët e fundit;
- 3.4 Qytetarët e huaj, të cilët kalojnë nëpër Kosovë përmes transportit të organizuar me autobus ose me linjë të rregullt ndërkombëtare, transit, me kusht që të nënshkruhet deklarata se do ta lëshojnë territorin e Kosovës brenda pesë (5) orësh;
- 3.5 Diplomatët e huaj, të akredituar në Kosovë dhe pjesëtarët e trupave të KFOR;
- 3.6 Personat nën moshën dymbëdhjetë (12) vjeçare;
- 3.7 Shtetasit e Republikës së Kosovës që nuk i kanë dy doza të vaksinës janë të detyruar të kryejnë karantinim shtëpiak për një periudhë prej shtatë (7) ditësh që nga hyrja në territorin e Republikës së Kosovës;
- 3.8 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi. Personat e tillë duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, të administruar jo më herët se 48 orë para nisjes (për udhëtarët që hyjnë në rrugë ajrore) ose 48 orë para mbërritjes në pikën kufitare (për ata që hyjnë në rrugë tokësore);
- 3.9 Personat nga mosha 12 vjeçare deri në moshën 16 vjeçare duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ jo më të vjetër se 48 orë.

C. [Mbrojtja dhe siguria në punë]

4. Të gjithë punonjësit e institucioneve publike, ndërmarrjeve publike qendrore e lokale, të bizneseve private, organizatave, si dhe subjektet tjera, duhet të posedojnë një nga dëshmitë e mëposhtme, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në ambientet e punës:
 - 4.1 Certifikatën e vaksinimit me më së paku dy doza ose një dozë të vaksinës Janssen kundër COVID-19;
 - 4.2 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ për COVID 19 jo më të vjetër se një javë.
5. Nëpunësi më i lartë administrativ, apo pozita ekuivalente, institucioneve publike, private, si dhe subjektet tjera, është i obliguar të caktojë një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërit nga dëshmitë e cekura në pikën 4.1 deri 4.2.
6. Punëdhënësit publik e privat, si dhe subjektet tjera obligohen që mbështetur në nevojat dhe natyrën e punës së tyre, të identifikojnë dhe të përcaktojnë stafin esencial, si dhe të organizojnë punën vetëm me këtë staf.
7. Punëdhënësit publik dhe privat, si dhe subjektet tjera udhëzohen të krijojnë kushtet për kryerjen e detyrave të punës nga shtëpia për punëtorët që nuk janë staf esencial, sipas nevojave të punëdhënësít.

Ç. [Masat e përgjithshme të mbrojtjes dhe higjienës]

8. Obligohen institucionet publike e private, si dhe subjektet tjera, të mbajnë dezinfektues për duar dhe një sasi të maskave në vende të qasshme në hyrje të objektit si dhe në ambientet e brendshme.
9. Obligohen institucionet publike e private, si dhe subjektet tjera që në hyrje të çdo objekti të vendosin shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga COVID-19, përfshirë shenjën e ndalimit të hyrjes në objekt pa maska, respektimin e distancës prej një (1) metër dhe shenja promovuese për vaksinim sipas dizajnit të Ministrisë së Shëndetësisë.
10. Obligohen përgjegjësit e institucioneve publike e private dhe subjektet e tjera që të kryejnë dezinfektimin dhe ajrosjen e hapësirave të myllura.

11. Bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është obligative në të gjitha rastet, përveç:

- 11.1 Gjatë ngasjes së automjetit vetëm, apo kur në automjet janë prezantë; ekskluzivisht anëtarët e ngushtë të familjes;
- 11.2 Gjatë vrapit, çiklizmit dhe ushtrimeve fizike;
- 11.3 Gjatë ngrënies apo pijes.

12. Ndalohet hyrja në ambientet e mbyllura pa maskë.

13. Obligojen të gjitha institucionet publike e private, si dhe subjektet tjera që të caktojnë një punonjës që do të monitorojë zbatimin e masës të përcaktuar në pikën 12 dhe posedimin e dëshmive sipas pikës 4.1 dhe 4.2.

D. [Kufizimi i qarkullimit]

14. Kufizimi i qarkullimit të qytetarëve do të jetë nga ora 22:00 deri në ora 05:00, përveç:

- 14.1 Rasteve të natyrës urgjente (për të kërkuar ndihmë mjekësore, blerje të barnave, për të ofruar kujdes ose ndihmë mjekësore, për të shhangur dëmtimin ose për t'i shpëtuar një rreziku lëndimi);
 - 14.2 Qarkullimit për personelin shëndetësor, të sigurisë dhe operatorët që kryejnë punë apo shërbime publike;
 - 14.3 Personelin e ndërrimit të natës të operatorëve ekonomikë që sigurojnë funksionimin e zinxhirit të furnizimit (përfshirë transportin e mallrave/shërbimeve), por me kusht që të pajisen me leje të veçantë nga sistemi EDI i Administratës Tatimore të Kosovës;
 - 14.4 Personat të cilët ofrojnë dëshmi se duhet të jenë në aeroport gjatë orarit të kufizimit të qarkullimit, për shkak se kanë për të udhëtuar përmes aeroplanit;
 - 14.5 Personave ndaj të cilët aplikohet leja e veçantë e përkohshme që lëshohet nga Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas pikës 16. për shkak të domosdoshmërisë së qarkullimit gjatë orës policore.
15. Obligojen punëdhënësit të sigurojnë që punëtorët e tyre që i nënshtronen kufizimit nga pika 14. të kenë kohë të mjaftueshme për të udhëtuar në banesat e tyre.
16. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme mundet që të lëshojë leje të veçantë, për persona të cilët ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për domosdoshmërinë që kufizimi i qarkullimit të orarit të ju zgjatet përkohësisht.

Dh. [Institucionet e arsimit]

17. Procesi edukativ-arsimor në institucionet parashkollore dhe të qëndrimit ditor zhvillohet sipas rekomandimeve për institucionet parashkollore të IKShPK të datës 20.01.2022.
18. Procesi edukativ-arsimor në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar të të gjitha niveleve, si dhe në qendrat e qëndrimit ditor zhvillohet në përputhje me Udhëzuesit të MASHTI për organizimin e procesit mësimor në kushtet e pandemisë COVID-19. Task forcat e institacioneve edukative-arsimore vendosin për aplikimin e skenarëve për organizimin e procesit mësimor, varësisht nga gjendja në institucion dhe në klasa.
19. Procesi mësimor në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, si dhe në institucionet aftësuese dhe të arsimit joformal, mund të zhvillohet me prani fizike me kusht që grupet mbi 50 persona të akomodohen në jo më shumë se 50% të hapësirës.

20. Studentët në mënyrë që të ju mundësohet regjistrimi në konvikt duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 4.1 ose 4.2.
21. Studentët në institucionet publike dhe private universitare duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 4.1 ose 4.2, në mënyrë që të ju lejohet hyrja në objektin e institucionit.
22. Stafi në të gjitha institucionet publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, duke përfshirë institucionet parashkollore dhe të qëndrimit ditor, duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 4.1 ose 4.2, në mënyrë që të ju lejohet hyrja në objektin e institucionit.
23. Nëpunësi më i lartë administrativ, apo pozita ekuivalente, i çdo institucioni sipas pikës 20, 21 dhe 22, është i obliguar me vendim të caktøjë një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 4.1 ose 4.2.
24. Të gjitha institacioneve publike dhe private të të gjitha niveleve të arsimit, iu ndalohet organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore, siç janë ekskursionet, shëtitjet gruopore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor apo të nxënësve – studentëve.

E. [Paraqitja për skemat sociale dhe pensionale]

25. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve udhëzohet të lirojë të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që menaxhohen nga MFPT-ja nga paraqitja e rregullt në zyrat përkatëse për qëllime të evidentimit, siç kërkohet me ligjet përkatëse.

F. [Kufizimi i mbledhjeve publike dhe private]

26. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Vendim, lejohen grumbullimet në ambiente të mbyllura deri në tridhjetë (30) persona (punëtori, mbledhje, seminare, trajnime apo grumbullime tjera). Përveç atyre nën moshën 12 vjeçare, obligohen pjesëmarrësit që të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 dhe pikën 26.2 në mënyrë që të ju lejohet hyrja në këto ambiente, si dhe organizatori obligohet të siguroj distancën fizike prej një (1) metër në mes të personave dhe kontrollimin e dëshmive përkatëse si:
 - 26.1 Certifikatën e vaksinimit me së paku dy doza ose një dozë të vaksinës Janssen kundër COVID-19;
 - 26.2 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më të vjetër se 48 orë.
27. Mbledhjet e Kuvendit dhe të Qeverisë lejohen pavarësisht numrit të personave, duke u respektuar mbajtja e maskave dhe distanca fizike prej një (1) metër në mes të personave.
28. Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Shëndetësisë mundet që të lëshojë leje të veçantë, që tejkalon numrin prej tridhjetë (30) persona, për ngjarje të rëndësisë së veçantë në funksion të interesit publik.
29. Lejohen grumbullimet dhe ngjarjet kulturore, në ambiente të jashtme deri në pesëdhjetë (50) persona (publiku). Organizatori obligohet të sigurojë mbajtjen e distancës fizike prej 1 metër në mes të personave dhe paraqitjen e dëshmive të evidentuar në pikat 26.1 ose 26.2 përveç pjesëmarrësve nën moshën 12 vjeçare.
30. Pavarësisht pikës 28 dhe 29, për koncerete dhe festivale me publik në këmbë vlejnë ndalesat e përcaktuara në pikën 34.

31. Ceremonitë dhe ritet fetare lejohen të zhvillojnë aktivitetin e tyre deri në 50% të kapacitetit shfrytëzues me kusht që posedojnë ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 26.1 ose 26.2 në mënyrë që t'u lejohet hyrja në hapësirat e mbyllura, në përputhje me udhëzuesin përkatës, përveç pjesëmarrësve nën moshën 12 vjeçare.

32. Ndalohet mbajtja e pritjes për ngushëllim/krye shëndoshë.

33. Lejohen funeralet vetëm me pjesëmarrje të familjes së ngushtë, duke siguruar që pjesëmarrësit të mbajnë distancë fizike prej një (1) metër nga njëri-tjetri.

G. [Ndalimi i veprimitarive dhe organizimeve të caktuara]

34. Pavarësisht numrit të personave, ndalohet veprimitaria e klubeve të natës si dhe organizimi i festivaleve, koncerteve, ekskursioneve, pelegrinazheve, dasmave, fejesave, ahengjeve familjare dhe shoqërore, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Gj. [Gastronomia]

35. Shërbimet e gastronomisë lejohen të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Klientët dhe stafi i gastronomisë duhet të posedojnë ndonjëren nga dëshmitë sipas pikës 26.1 ose 26.2 në mënyrë që t'u lejohet hyrja në hapësirat e mbyllura të lokaleve, në përputhje me udhëzuesin përkatës, përveç atyre nën moshën 12 vjeçare.

36. Në lokalet e gastronomisë është e obliguar të caktohet një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërs nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2.

37. Shfrytëzimi i hapësirave të mbyllura lejohet deri në pesëdhjetë (50%) e kapacitetit të hapësirës. Në hapësirat e hapura lejohet shfrytëzimi deri në shtatëdhjetë (70%) e kapacitetit të hapësirës. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku shërbehet ushqimi dhe pijet.

38. Kuptimi i shprehjes 'hapësirë e hapur' dhe 'hapësirë e mbyllur' ka të njëjtin kuptim me Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

39. Klientët duhet të qëndrojnë ulur në çdo kohë në kuadër të lokaleve të shërbimeve të gastronomisë në të cilën lejohet shërbimi i ushqimit apo pijeve, përveç:

- 39.1 Gjatë hyrjes apo daljes nga ambienti i lokalit;
- 39.2 Ndërsa paguan porosinë;
- 39.3 Gjatë shkuarjes apo kthimit nga tualeti;
- 39.4 Kur është e nevojshme për qëllime të shëndetit dhe sigurisë.

40. Në rastet nga pika 39.1 deri 39.4 është e obliguar bartja e maskës.

41. Shërbimet e gastronomisë lejohet të zhvillojnë aktivitetin e tyre nga ora 05:00 deri në orën 21:00.

42. Muzika lejohet vetëm deri në orën 20:30.

43. Përgjegjësit e lokaleve duhet të sigurohen që distanca ndërmjet klientëve në tavolina të ndryshme të jetë së paku një (1) metër.

44. Pjesa e prapme e një karrigeje, me pjesën e prapme të karriges tjetër duhet jenë në distancë së paku një (1) metër.

45. Në hapësirat e mbyllura lejohen deri në 4 persona në tavolinë. Në rast se tavolinat janë më të mëdha se dy (2) metra, atëherë parakusht është kufizimi prej pesë (5) persona në 10 m².

46. Në hapësirat e jashtme lejohen deri në gjashtë (6) persona në tavolinë apo banak.
47. Çdo tavolinë duhet të jetë e pajisur me dezinfektues që përbajnjë së paku 60% alkool.
48. Shërbimi "dërgesë me porosi" lejohet të funksionojë edhe pas orës 21:00, pas pajisjes me leje të veçantë nga sistemi EDI (ATK) dhe masa rigorozë të higjenës për veturën, porositë dhe personelin.

H. [Qendrat tregtare dhe operatorët e tjerë ekonomik]

49. Lejohet veprimitaria e qendrave tregtare sipas udhëzuesit përkatës.
50. Obligohen të gjithë operatorët, të cilët për veprimitari ekonomike e kanë tregtinë me shumicë dhe pakicë, që të përcaktojnë numrin maksimal të klientëve në lokal në të njëjtën kohë sipas rregullit - një (1) person për 8 m². Këta operatorë obligohen të shënojnë në hyrje numrin maksimal të klientëve të lejuar në të njëjtën kohë. Sipërfaqja llogaritet për zonën ku lejohen të qëndrojnë klientët.
51. Klientët dhe stafi në qendra tregtare duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në objekt, përveç atyre nën moshën 12 vjeçare.
52. Subjekti që menaxhon me qendrën tregtare është i obliguar të caktojë një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2. dhe atë në secilën hyrje të qendrës tregtare.

I. [Puna me palë]

53. Në institucionet publike, private dhe subjekte tjera, punonjësit/personeli i cili ka punë me palë/kontakt të drejtpërdrejtë me klientë (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, berberë, vozitësit e takstive, punonjësit në markete dhe banka etj.), duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në vendin e punës. Obligohet të caktohet një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2. Inkurajohet pranimi i pagesave në formë elektronike, në vend të keshit.
54. Personi përgjegjës i institucionit publik, privat apo i subjekteve tjera, obligohet që të ndalojë rreshtimin apo tubimin brenda dhe jashtë ambientit të punës/biznesit, përveç nëse mbahet distancë fizike prej të paktën 1 metër nga grupet e tjera të personave.

J. [Transporti publik dhe ndërkombëtar]

55. Ndalohet hyrja në mjetet e transportit publik dhe ndërkombëtar pa maskë.
56. Operatorët e transportit rrugor të udhëtareve lejohen të punojnë duke shfrytëzuar 50% të kapacitetit të ulëseve.
57. Në taksi lejohen të udhëtojnë deri në dy (2) udhëtarë.
58. Stafi dhe pasagjerët e transportit publik duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2, në mënyrë që t'u lejohet veprimitaria, respektivisht udhëtimi në mjetet e transportit publik dhe ndërkombëtar, përveç atyre nën moshën 12 vjeçare.

59. Secili operator është i obliguar të caktojë një apo më shumë persona përgjegjës në çdo mjet të transportit publik, që do të kontrollojnë pasagjerët për posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2.

K. [Teatrot, bibliotekat, etj.]

60. Bibliotekat, muzetë, kinematë, teatrot, qendrat rimore, qendrat e kulturës me grupe apo institucionet tjera të ngjashme vartëse të MKRS-së apo të Komunave, lejohet të punojnë duke shfrytëzuar 30% të kapacitetit të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse, me kusht që publiku të jetë i ulur në karrige. Obligohet mbajtja e maskës dhe distancës fizike prej një (1) metër në mes të personave.
61. Shfrytëzuesit e veprimtarive sipas pikës 60, duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2, në mënyrë që t'ju lejohet hyrja në objekt, përveç atyre nën moshën 12 vjeçare.
62. Në veprimtaritë sipas pikës 60, duhet të caktohet me vendim një apo më shumë persona përgjegjës që do të kontrollojnë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2.

L. [Sporti dhe rekreacioni]

63. Lejohen organizimi i garave sportive dhe stërvitjeve përkitazi me protokollet dhe rekomandimet e organizatave botërore për organizimin e ngjarjeve sportive dhe me masat mbrojtëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
64. Numri i pjesëmarrësve në garë (sportistë, klube, zyrtarë, dhe pjesëmarrës tjerë të nevojshëm për zhvillimin e garës) përcaktohet nga federatat sportive duke respektuar masën e distancës dhe masat tjera mbrojtëse. Në aktivitetet garuese në hapësira të mbyllura dhe të hapura nuk lejohet prania e shikuesve.
65. Mbyllen fitneset, palestrat dhe institucione të tjera për shfrytëzim të publikut për aktivitete sportive dhe rekreative, me përjashtim të klubeve profesionale sportive.

LL. [Banjat termale]

66. Për të hyrë në banja termale, klientët dhe stafi duhet të posedojnë ndonjërën nga dëshmitë e përcaktuara në pikën 26.1 ose 26.2 të këtij Vendimi, përveç atyre nën moshën 12 vjeçare. Obligohet caktimi i të paktën një punonjësi i cili do të kontrollojë posedimin e ndonjërës nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 ose 26.2.

M. [Tregjet dhe therja e kafshëve]

67. Tregjet publike të automjeteve, kafshëve dhe shpezëve lejohet të zhvillojnë veprimtarinë duke shfrytëzuar 30% të kapacitetit të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse. Obligohet mbajtja e maskës dhe vendosja e tezgave në distancë fizike prej të paktën dy (2) metra.

N. [Të dhënat personale dhe mënyra e kontrollimit të dëshmive sipas pikës 4.1 deri 4.2]

68. Caktimi i personave të autorizuar apo punonjësve të autorizuar për kontrollimin e dëshmive sipas pikën 26.1 ose 26.2, bëhet përmes Vendimit ku përcaktohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar. Këta persona duhet të jenë të identifikueshmë përmes kartelës/shenjës identifikuese dhe emrat e tyre të afishohen në hyrje të institucionit, qendrave tregtare, lokaleve të gastronomisë dhe cilitdo biznes tjetër.
69. Prezantimi i dëshmive të përmendura në pikën 26.1 ose 26.2, bëhet në një formë e cila nuk lejon që personat e autorizuar ose shërbimet e autorizuara për të kontrolluar posdimin e tyre, t'i mbajnë, t'i ruajnë, t'i regjistrojnë apo përpunojnë të dhënat që përbëhen në dëshmi në çfarëdo forme, përpos nëse subjekti i të dhënavë ka dhënë pëlqimin e tij në formë të shkruar për përpunimin e këtyre të dhënavë.
70. Personat e autorizuar dhe të caktuar me emër, për të kontrolluar dëshmitë përmendura në pikën 26.1 ose 26.2, në rastet kur subjekti i të dhënavë ka dhënë pëlqimin e tij në formë të shkruar për përpunimin e këtyre të dhënavë, nuk lejohen t'i mbajnë të dhënat ose ripërdorin ato për qëllime të tjera, përvç për konstatimin e posdimit të dëshmive, në interes të shëndetit publik dhe për qëllimet e vetme për të luftuar përhapjen e pandemisë COVID-19.

Nj. [Udhëzuesit dhe sqarimet]

71. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që të përditësojë udhëzuesit e përkohshëm, të përgjithshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, si në vijim:
 - 71.1 Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e COVID-19;
 - 71.2 Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
 - 71.3 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të të gjitha niveleve;
 - 71.4 Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
 - 71.5 Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore;
 - 71.6 Udhëzues i Përkohshëm për fitnese, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
 - 71.7 Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik dhe ndërkombëtar;
 - 71.8 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
 - 71.9 Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
 - 71.10 Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj;
72. Udhëzuesit nga pika 71 janë të detyrueshmë për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohen.
73. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që në rast nevoje të nxjerr sqarime për pikat e këtij Vendimi.

O. [Zbatimi]

74. Obligohet Ministri i Shëndetësisë, AUV dhe Policia e Kosovës, që në bashkëpunim me shtabet emergjente komunale, të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi dhe të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raport favor (çdo të premte deri në orën 16:00).
75. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK dhe IKShPK të dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrat raportin favor (çdo të premte deri në orën 16:00) për zbatimin e masave, gjendjen në institucionet shëndetësore, gjendjen epidemiologjike dhe parashikimet për dy javët në vijim.
76. Obligohet Ministria e Shëndetësisë që, bazuar në Ligjin Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, në territorin e Republikës së Kosovës të nxjerrë vendime operacionale varësish prej situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve të IKShPK-së.
77. Obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e masave, vendimeve të tjera dhe udhëzuesve përkatës në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.
78. Për shkelësit e masave, organet kompetente obligohen të shqiptojnë masat ndëshkimore sipas Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.
79. I vetmi autoritet që mund të interpretojë këtë Vendim është Ministria e Shëndetësisë, ndërkaq çdo institucion tjetër mund të ofrojë sqarime për kategoritë respektive për të cilat aplikohet ky Vendim, vetëm pas miratimit të atij sqarimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

P. [Shfuqizimi i vendimit Nr. 02/46]

80. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/46, i datës 30.11.2021.

Q. [Hyrja në fuqi]

81. Vendimi hyn në fuqi më 22 janar 2022, dhe vlen deri më datën 4 shkurt 2022.

A r s y e t i m

Masat për ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen nga COVID-19 janë provuar si jetike për të kufizuar përhapjen e COVID-19. Sipas raporteve të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, situata epidemiologjike me COVID-19, në Kosovë është stabile, por rreziku mbetet sepse varianti Omicron është dominues. Më datën 26 nëntor 2021, OBSh ka njoftuar për shfaqjen e variantit të ri të quajtur Omicron si variant shqetësues ku kërkohet vigjilencë e shtuar në mbikëqyrjen epidemiologjike si dhe zbatimin e masave si vaksinimi dhe masave jo farmaceutike për të parandaluar përhapjen e COVID-19.

Më datën 26 dhjetor 2021, në laboratorin e Mikrobiologjisë në IKShPK është detektuar varianti Omicron i SARS-CoV-2 në Kosovë. Në një situatë të tillë, duke iu referuar të dhënavë aktuale mbi situatën epidemiologjike, klasifikimin e shkallës së përhapjes dhe rekomandimeve të IKShPK - së, si dhe kapacitetit të sistemit shëndetësor dhe shërbimeve shëndetësore publike, Qeveria ka ndërmarrë masa të cilat kanë për qëllim ruajtjen e shëndetit publik si dhe parandalimin e shpërndarjes së COVID-19.

Në bazë të të dhënave shkencore në dispozicion, rreziqet e përhapjes të virusit COVID-19 zvogëlohen tek personat e vaksinuar plotësisht dhe me dozë përforcuese që sapo kanë rezultuar negativ (RT-PCR) në COVID-19. Andaj, Qeveria ka ndërmarrë masa kufizuese, përfshirë edhe orarin e lëvizjes me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të shpërndarjes së COVID-19 në aktivitetet të cilat bashkojnë një numër të madh njerëzish në të njëjtin vend, dhe në të cilat ruajtja e distancës fizike është e vështirë dhe kështu paraqesin një rrezik në rritje të përhapjes të virusit. Të dhënat e fundit shkencore tregojnë që vaksinimi është mjeti më efikas në parandalimin e formave të rënda të sëmundjes dhe të vdekjes.


Masat e ndërmarra janë proporcionale me rreziqet shëndetësore të shkaktuara dhe të përshtatshme me rrethanat e kohës dhe vendit, si dhe të bazuara në autorizimet e Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Masat e ndërmarra përmes këtij Vendimi nuk përcaktojnë, në asnjë rast obligimin e vaksinimit të detyrueshëm, duke qenë se kufizimet e vendosura ndaj publikut mund të përbushen me paraqitjen e dëshmisë së statusit të vaksinimit, të rezultatit të një testimi që arrin në përfundimin se personi nuk është i infektuar me COVID-19.

Vendimi për masat kundër COVID-19 është bazuar në vlerësimin e situatës së intensitetit të përhapjes dhe kapacitetit të sistemit shëndetësor për t'u përgjigjur, por duke i vlerësuar ato edhe nën drithën e efekteve të këtyre masave që mund të ketë në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë dhe individëve.

Ministria e Shëndetësisë ka bashkërenduar vendimmarjen me palët e interesit, të cilat kanë qenë të ndikuara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga pandemia. Qeveria vëren se këto palë kanë ushtruar të drejtën e tyre për ndikim demokratik në vendimarrje, në përputhje me nenin 45.3 të Kushtetutës.

Masat e përcaktuara në këtë Vendim si dhe afatet kohore shërbijnë që situata epidemiologjike të mbahet nën kontroll por nuk përjashtojnë mundësinë e ndërmarrjes së masave të reja kufizuese apo lehtësuese.

Prandaj, në bazë të rekomandimeve të dhëna nga IKShPK-së, ministritë e linjës, palët e interesit dhe ekspertët përkatës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Komunave
- Inspektorateve përgjegjëse
- Policisë së Kosovës
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/55

Datë: 21.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e 14 (katërmëdhjetë) vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Ministria e Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar dhe
 - 1.5. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrat, anëtar.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues, Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4. Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar dhe
 - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/55

Datë: 21.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 par.4 dhe nenit 3 par.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 53 paragrafi 1. dhe nenit 55 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 32 paragrafi 4, nenit 60 paragrafi 1.4. dhe nenit 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të nenit 4 paragrafi 2. të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr. 908/2021 të datës 05.01.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 21 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Pas rishqyrtimit të Vendimit të Qeverisë Nr. 34/39 të datës 13.10.2021, në bazë të udhëzimit të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.13/59 i datës 21.01.2021, përmes të cilit z. Fatos Qerimi i është vazhduar mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.
2. Obligohen institucionet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 34/39 i datës 13.10.2021.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/35 të datës 09.03.2018, z. Fatos Qerimi emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, me mandat tre (3) vjeçar.

Po ashtu me Vendimin e Qeverisë Nr.12/33 të datës 28.09.2020, z. Qerimi si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ende pa i përfunduar mandati, transferohet në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, i cili qartë përcakton se transferimi i z. Qerimi bëhet brenda mandatit të përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/35. të datës 09.03.2018.

Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/59 të datës 21.01.2021, z. Qerimi i vazhdohet mandati Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit edhe përkatër vite (4), duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik, nen i cili rregullon çështjen e transferimit të përkohshëm.

Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në rastet kur: është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve, për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve, për arsyë të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

Vazhdimi i mandatit të z. Qerimi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (tani Ministria e Ekonomisë) edhe për katër vite (4) sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 13/59 të datës 21.01.2021 pozitë në të cilën ka qenë përkohësisht i transferuar, është në kundërshtim me pikën 2. të Vendimit e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 12/33 të datës 28.09.2020 i cili përcakton se transferimi i z. Qerimi bëhet brenda mandatit të përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/35 të datës 09.03.2018.


Vazhdimi i mandatit të z. Qerimi është po ashtu në kundërshtim me nenin 52. paragrafi 6. i Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë i cili parashev që në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme.

Nisur nga kjo që u tha më lart, bëhet e qartë që z. Qerimi, prej nxjerrjes së Vendimit Nr. 13/59 të datës 21.01.2021, në asnjë moment ligjërisht, nuk ka pasur të drejtë ushtrojë pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, marrë parasysh që nuk ka fituar ligjshëm pozitën e me të edhe të drejtat e krijuara. Nisur nga kjo e në bazë të nenit 49 paragrafi 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, panevojshmëria e arsyetimit parashihet kur: "akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale". Siç evidentohet lehtësisht nga më lart, në rastin e shfuqizimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes të cilit emërohet z. Fatos Qerimi në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, në të vërtetë nuk ka pasur nevojë për arsyetim, marrë parasysh që nga ky i fundit asnjë e drejtë e fituar ligjërisht nuk është marrë. Së fundmi, kështu e dikton edhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Megjithatë, me qëllim të respektimit të Vendimit të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Qeveria ka vepruar sipas udhëzimeve të këtij të fundit, duke konfirmuar përmes këtij Vendimi, verdiktin e dhënë me marrjen e Vendimit të Qeverisë Nr. 34/39 të datës 13.10.2021.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 30 tridhjetë ditësh, pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Z. Fatos Qerimi
- KPMShCK
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/55

Datë: 21.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 par.4 dhe nenit 3 par.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 53 paragrafi 1. dhe nenit 55 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 32 paragrafi 4. nenit 60 paragrafi 1.4. dhe nenit 83 paragrafi 9. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Nenit 4 paragrafi 2. të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr. 953/2021 të datës 06.01.2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 21 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Pas rishqyrtimit të Vendimit të Qeverisë Nr. 11/44 të datës 21.11.2021, i kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil përmes Vendimit A. Nr. 953/2021, të datës 06.01.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës vodos të mbetet pranë shfuqizimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.16/31 i datës 21.09.2020, me të cilin z. Shpen Trdevaj emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me qëllim të kthimit të ligshmërisë.
2. Marrë parasysh që procesi i rekrutimit dhe emërimi i z. Shpen Trdevaj është bërë në pajtim me legjislacionin e shfuqizuar për Shërbimin Civil, në kohën kur në fuqi ishte Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili shprehimisht ndalon veprim të atillë, emërimi aktual në pozitën e Sekretariat të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë është i pavlefshëm, marrë parasysh që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që diktojnë rekrutimin në pozitë të këtillë menaxhuese.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 11/44 i datës 10.11.2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është publikuar në Gazetën Zyrtare më 11.03.2019. Ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, por, zbatimi i tij u pezullua me vendim të Gjykatës Kushtetuese me masë të përkohshme deri më 09.07.2020 kur vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtij Ligji u vendos përfundimisht rasti nr. KO 203/19. Konkursi publik për pozitën e Sekretariat të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës u publikua me datë 25.06.2020 nga Ministria e Punëve të Brendshme përderisa emërimi i z. Shpen Trdevaj u krye me datë 21.09.2020 me Vendimin e Qeverisë Nr.16/31.

Konkursi për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është hapur para se të hyjë në fuqi Ligji për Zyrtarët Publikë, por, procedura e rekrutimit ka përfunduar pasi që Ligji për Zyrtarët Publik ka hyrë në Fuqi.

Neni 83.9 e Ligjit për Zyrtarët Publikë përcakton se:

"Institucionet publike do të sigurojnë përfundimin e konkursit të shpallur dhe procedurave të tjera të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedurat që janë në vazhdim e sipër, kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë sipas ligjit të ri. Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me kërkësën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjtë procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve."

Nga kjo rrjedhë që procedura e rekrutimit të Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës është dashur të vazhdojë sipas procedurave të përcaktuar me Ligjin për Zyrtarët Publik.

Fillimisht, sa i përket pranimit në pozita të kategorisë së lartë drejtuese Neni 40 pika 1. e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcakton se:

"Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil."

Pra, për çdo pozitë të kategorisë së lartë drejtuese duhet fillimisht të organizohet një konkurs i brendshëm në Shërbimin Civil ku mund të marrin pjesë të gjithë bartësit e pozitave të larta dhe të mesme drejtuese. Një gjë e tillë është e përcaktuar dhe në Nenin 6 pika 5. e Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku thuhet:

"Njostimi për shpalljen e konkursit për herë të parë është për nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil dhe bëhet në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit për nëpunësit civilë (SIMBNJ) dhe në ueb faqen e institucionit..."

Mirëpo, Vendimi i Qeverisë Nr.16/31 i datës 21.09.2020, përmes së cilit z. Shpen Trdevaj emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, ka hyrë në fuqi sipas një konkursi të jashtëm të shpallur më 25.06.2020. Shpallja e një konkursi të tillë para se të organizohet konkursi i brendshëm në Shërbimin Civil për pozitat e larta dhe të mesme drejtuese përbën shkelje të Nenit 40 pika 1. të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Nenit 6 pika 5. e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Përmes prioritizimit të konkursit të brendshëm në Shërbim Civil synohet që të mundësohet realizimi i së drejtës së nëpunësve civil për të zhvilluar karrierë në Shërbim Civil. Anashkalimi i konkursit të brendshëm përmes shpalljes së hapur për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, përvëc që përbën shkelje të legjislacionit në fuqi, shkel dhe këtë të drejtë që i garantohet nëpunësve civil me ligj.

Tutje, Ligji për Zyrtarët Publikë si dhe Rregullorja Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues përcaktojnë procedura të ndryshme sa i përket procedurave të aplikimit, vlerësimit dhe përbërjes së komisionit të pranimit në krahasim me ato që ishin të përcaktuara me Ligjin për Shërbyes Civil dhe Rregullores Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Marrë parasysh që procesi i rekrutimit dhe emërimi i z. Shpen Trdevaj është bërë në pajtim me legjislacionin e shfuqizuar për Shërbimin Civil, në kohën kur në fuqi ishte Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili shprehimisht ndalon veprim të atillë, emërimi aktual në pozitën e Sekretariat të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë është i pavlefshëm, marrë parasysh që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që diktojnë rekrutimin në pozitë të këtillë menaxhuese. Siç evidentohet lehtë në bazë të gjendjes faktike të procedurës së rekrutimit të z. Trdevaj, kjo e fundit nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, përfshirë aktet


nënligjore të bazuara në Ligjin për Zyrtarët Publikë, por ka vazhduar me ato të Ligjit për Shërbimin Civil, duke rezultuar me procedurë tërësisht të pavlefshme, në aspektin ligjor.

Nisur nga kjo që u tha më lart, bëhet e qartë që z. Trdevaj në asnjë moment ligjërisht, nuk ka pasur të drejtë të ushtrojë pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë, marrë parasysh që nuk ka fituar ligjshëm pozitën e me të dhe të drejtat e krijuara në bazë të procedurës së rekrutimit. Nisur nga kjo e në bazë të nenit 49 paragrafi 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, panevojshmëria e arsyetimit parashihet kur: "akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale". Siç evidentohet lehtësisht nga më lart, në rastin e shfuqizimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes të cilit emërohet z. Shpen Trdevaj në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë, në të vërtetë nuk ka pasur nevojë për arsyetim, marrë parasysh që nga ky i fundit asnjë e drejtë e fituar ligjërisht nuk është marrë. Së fundmi, kështu e dikton edhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Megjithatë, në qëllim të respektimit të vendimit të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Qeveria ka vepruar sipas udhëzimeve të këtij të fundit, dhe ka ofruar arsyetim për shfuqizimin e Vendimit të lartcekur, duke konfirmuar përmes këtij Vendimi, verdiktin e dhënë me marrjen e Vendimit të Qeverisë Nr.11/44 të datës 21.11.2021.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej 30 tridhjetë ditësh, pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Z. Shpen Trdevaj
- KPMShCK
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/55

Datë: 21.01.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, duke u bazuar në rekomandimin e Komitetit Teknik-Emergjent të datës 21.01.2022, në pajtim me në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Bazuar në nevojën emergjente për tejkalimin e krizës energjetike përmes subvencionimit sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 02/41 të datës 17.12.2021, në bazë të marrëveshjes me nr. Prot. 3247, të datës 22.12.2021, në mes të KEK-ut, Ministrisë së Ekonomisë, NJPMNP, aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 10,000,000.00 €, (dhjetë milion euro), për zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike për masën 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1 të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në nën-programin "Njësia për Politikat dhe Monitorimin e NP-ve" me kod 23300, për mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë të bëjë transferimin e mjeteve financiare tek Ndërmarrja Publike KEK Sh. A.
4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen me marrëveshje që lidhet në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe N.P. KEK. Sh. A.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/55

Datë: 21.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministritë e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbështetje financiare shumë prej 95,725.00 € (nëntëdhjetepesë mijë e shtatëqindjenjëzetepesë) euro, për zbatimin e Masës 4.3 - Mbështetja e Kulturës dhe Sportit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207 në nën programin Qendra Kinematografike e Kosovës me kod 81400 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Këto mjete financiare do të përdoren për mbështetje të pjesës së dytë të kampanjës së filmit "Zgjoi", i nominuar nga Republika e Kosovës përkatësisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qendra Kinematografike e Kosovës, për të garuar në kuadër të Akademisë së Oscars.
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministritë (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë